



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:106384

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05568737

PKR.nr.263/2007

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari Fatos Sejdiqaj, me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.A. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK), akuzuar sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP-II.nr.276/2006 të datës 04.10.2007, jashtë seancës, e në kuptim të nenit 357 par.1, nënpar.1.3 lidhur me nenin 158 par.1 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje:KPP), më datë 12.04.2024, nxjerrë këtë :

A K T V E N D I M

I.- Hedhet Aktakuza e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.276/2006 të datës 04.10.2007, dhe **Pushohet** procedura penale ndaj të pandehurit : **L.A.**, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, lindur më datë, në-Mitrovicë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, për veprën penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së, **për shkak se i njëjti ka vdekur.**

II.- Në mbështetje të nenit 276 par.1 të KPP-së, URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i armës-pushkës gjysmëautomatike, prodhim kinez, me numër serik 20041905, të kalibrit 7.62 mm. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, kjo armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, sipas procedurave ligjore në fuqi.

III.- Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

IV.- Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte.

A r s y e t i m

- Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.276/2006 të datës 04.10.2007, kundër të pandehurit L.A. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

- Me këtë çështje penale Kryetari i Trupit Gjykses është ngarkuar me datën 19.01.2024.

- Gjykata në këtë çështje penale ka ndërmarë veprime ligjore në drejtim të zhvillimit të procedurës penale ndaj të pandehurit, me ç'rast kishte caktuar seancën e shqyrtimit fillestar për datën 13.12.2007, mirëpo zarfi i ishte kthyer i mbyllur Gjykatës me konstatimin e dorëzuesit se, **“pala ka vdekur”**, konstatim i cili është dhënë dhe nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë, përmes komunikimit elektronik e-mailit zyrtar në adresë të Gjykatës me datë 23.01.2023, të cilët kanë theksuar dhe konfirmuar se për këtë janë njoftuar nga disa fqinj dhe bashkëshortja e të pandehurit, znj.M.L..

- Me parashtrësën me shkrim-Urdhëresën P.nr.263/2007 datë 24.01.2023, Gjykata ka urdhëruar Bashkësinë Islame të Kosovës-Dega në Mitrovicë, që t'ia dërgojnë Gjykatës kopjen nga regjistrat e librit të vdekjes për të pandehurin nëse i njëjti është i regjistruar si i vdekur, ashtu që të njëjtit me parashtrësën me shkrim Nr..... të datës, i janë përgjigjur urdhëresës së Gjykatës duke e njoftuar se, lidhur me këtë të pandehur bazuar në shënimet të cilat i posedojnë, i njëjti nuk gjendet në regjistrin e të vdekurve në Këshillin e Bashkësisë Islame-Dega në Mitrovicë.

- Me qëllim të mbledhjes së informacioneve për këtë të akuzuar gjegjësisht nga Sistemi për Menagjimin Informativ të Lëndëve (SMIL) i cili është i ndërlidhur me Agjencinë e Regjistrimit Civil, Gjykata ka gjetur se i pandehuri nuk e evidentohet në këtë sistem, për çka Gjykata me parashtrësë me shkrim të datës 21.02.2024 përmes komunikimit elektronik e-mailit zyrtar, i është drejtuar Komunës së Mitrovicës, përkatësisht zyrës së gjendjes civile, me kërkesën për vërtetimin e faktit të vdekjes për këtë të pandehur.

- Me datë 22.02.2024, Komuna e Mitrovicës përmes e-mailit zyrtar pas verifikimit të të pandehurit, kanë njoftuar Gjykatën se i pandehuri nuk gjendet i regjistruar në sistem as i lindur por, as si i vdekur.

- Gjykata, bazuar në të gjitha veprimet e ndërmarra ligjore në drejtim të zhvillimit të procedurës penale ndaj të pandehurit lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe ndërmarrjes së veprimeve me drejtim të sigurimit të informatave përmes komunikimit zyrtar sipas nenit 67 të KPP-së, me institucionet-organet publike dhe jo publike, ka vërtetuar se i pandehuri ka vdekur, por që në librin amzë të të vdekurve nuk është regjistruar i njëjti, dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka arritur që të sigurojë aktin formal të vdekjes së tij nga Zyra e Gjendjes Civile në Mitrovicë, gjegjësisht certifikatën e vdekjes në emër të tij.

- Duke qenë se, Gjykata konstatoj se në rastin konkret i pandehuri ka vdekur, duke u bazuar në nenin 357 par.1, nënpar.1.3 lidhur me nenin 158 par.1 të KPP-së, vendosi që ta hedh aktakuzën dhe të pushoj procedurën penale për të pandehurin L.A., të ngritur nga ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.276/2006 me datë 04.10.2007, i akuzuar për veprën penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

- Neni 357 par.1 i KPP-së përcakton se : *“Gjyqtari i vetëm gjykues ose Trupi gjykues me aktvendim e hedh aktakuzën kur : nënpar.1.3 “ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen”*. Ndërsa, neni 158 par.1 i KPP-së ka përcaktuar se :*“Kur gjatë rrjedhës së procedurës penale vërtetohet se i pandehuri ka vdekur, varësisht nga faza e procedurës penale, prokurori i shtetit apo **Gjykata merr aktvendim për pushimin e procedurës penale**”*.

- Gjykata vendosi si në pikën –II- të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 276 par.1 të KPP-së, ashtu që ndaj të pandehurit urdhëroi konfiskimin e përhershëm të armës-pushkës gjysmëautomatike, prodhim kinez, me numër serik 20041905, të kalibrit 7.62 mm, e cila armë pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale Gjykata e mbështeti në nenin 453 par.1 të KPP-së.

- Për arsyet e lartcekura, e në kuptim të nenit 357 par.1, nënpar.1.3 lidhur me nenin 158 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.263/2007, me datë 12.04.2024.

Kryetari i Trupit Gjykes,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.